



Politika për Sanksione

Shtator 2016

Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Përmbajtjes	1
Qëllimi i Politikës.....	2
Përkufizimet	2
Fushëveprimi	2
Përgjegjësitë Tuaja	3
Udhëzimi Praktik dhe praktikat më të mira.....	4
1. Kujdesi i duhur për Klientin/Furnizuesin duhet të bëhet kur:	4
2. Kujdesi i duhur për Klientin/Furnizuesin duhet të synoj të:	4
3. Shqyrtimi i palëve bashkëpunëtoreshë	4
4. Trajnimi	5
5. Auditimi gjurmues dhe mbajtja e evidencës.....	5
Shkeljet	5
Shtojca A	6
Listat e sanksioneve	6
Shtojca B	7
Shtojca C	8

Qëllimi i Politikës

Si rezultat i pranisë sonë ndërkombëtare dhe obligimeve tona kontraktuale të Grupit Titan, ne duhet të sigurojmë zbatimin e Sanksioneve të shqiptuara, administruara apo të zbatuara kohë pas kohe nga organizata/organe ndërkombëtare apo nga organe kombëtare të shteteve ku vepron Grupi Titan. Nga Grupi Titan pritet të zbatoj dhe mirëmbajë sisteme dhe kontrolle adekuate për të siguruar pajtueshmërinë me sanksionet.

Përkufizimet

Sanksion do të thotë sanksion ekonomik apo financiar, apo embargo tregtare të shqiptuara, administruara apo zbatuara kohë pas kohë nga shtetet dhe / apo organet ndërkombëtare (e.g. OKB, BE).

Personi i sanksionuar do të thotë çdo person apo entitet i listuar në çdo listë të Sanksioneve për persona të caktuar, për çdo person që është duke vepruar, që është i organizuar apo që është banor në një Shtet të Sanksionuar; apo çdo person i kontrolluar nga një person i tillë.

Shteti i sanksionuar do të thotë, në çdo kohë, një vend apo territor i cili i nënshtrohet apo është cak i çfarëdo Sanksioni.

Listat e Konsoliduara do të thotë lista që përfshijnë të gjithë emrat e personave, entiteteve dhe shteteve të sanksionuara, të lëshuara nga organet kombëtare apo organizatat ndërkombëtare.

Fushëveprimi

Kjo politikë zbatohet për të gjithë punonjësit që punojnë në të gjitha nivelet dhe kategoritë, duke përfshirë drejtorët, menaxherët e lartë, oficerët dhe punonjësit (bashkërisht “punonjësit”), të Grupit TITAN. Të gjithë punonjësit duhet të respektojnë Sanksionet e vendosura, administruara apo të zbatuara nga:

- Këshilli i Sigurimit i OKB-së
- BE-ja
- Qeveria e SHBA-së (duke përfshirë ato të administruara nga Zyra për Kontrollin e Pasurive të Huaja (OFAC), Departamenti i Thesarit i SHBA-së dhe Departamenti i Shtetit të SHBA-ve)
- Mbretëria e Bashkuar
- shtetet ku entiteti në fjalë i Grupi TITAN punon dhe është i inkuorporuar/regjistruar.

Sanksionet mund të jenë të formave të ndryshme. Për shembull, Sanksionet tregtare shtrihen nga ndalimet e tregtimit me të gjitha mallrat që ndërlidhen me një vend/rajon të veçantë, deri te ndalimet e tregtisë për mallra të caktuara. Ngjashëm, Sanksionet Financiar shtrihen nga ndalimet për të gjitha transaksionet që ndërlidhen me një vend/rajon të veçantë, deri tek kufizimet apo ndalimet për eksport apo transaksione për investime në një vend/rajon të veçantë.

Përgjegjësitë tuaja

Menaxherët e departamenteve të cilët me gjasë do të mund të përfshihen në çështje të Sanksioneve, sikurse tregtia, prokurimi apo financat, duhet të ndërmarrin hapat në vijim:

- Të përdorin dhe të jenë në gjendje të demonstrojnë se përdorin në mënyrë të arsyeshme dhe proporcionale **kujdesin e duhur dhe programet e shqyrtimit të sanksioneve** për të zbatuar ligjet në fuqi për Sanksione; kjo mund të bëhet ose në mënyrë manuale (për shembull, duke i përdorur linqet në Shtojcën A), apo duke përdor softuer automatik për shqyrtimin e klientëve i cili ofrohet nga ofruesit komercial të pranuar, apo duke angazhuar tërësisht apo pjesërisht shërbime nga ofrues të specializuar të jashtëm për shqyrtim dhe/apo procese tjera për zbatim të Sanksioneve.
- Të përdorin siç duhet **klauzolat të Sanksioneve** në të gjitha **transaksionet** tregtare (**shembujt mund të gjinden në Shtojcën B**).

Grupi TITAL kërkon që partnerët e tij të mos angazhohen apo të mos ndihmojnë në ndonjë aktivitet biznesor e cila do të shkaktonte që Grupi TITAN të shkelte ndonjë sanksion të zbatuar.

Inkurajoheni të kontaktoni Departamentin tuaj Ligjor në rast se keni ndonjë pyetje apo sqarim sa i përket zbatimit e kësaj politike. Kjo Politikë mund të ndryshohet kur të konsiderohet e nevojshme nga Departamenti Ligjor i Grupit.

Udhëzimi Praktik dhe praktikat më të mira

1. Kujdesi i Duhur për Klientin/Furnizuesin duhet të bëhet kur:

- Krijohet një marrëdhënie e re me një klient/furnizues
- kryhet një transaksion i rastit
- dyshohet për pastrim të parave apo financim të terrorizmit apo
- dyshohet vërtetësia apo pranueshmëria e provave që janë marrë më parë për qëllime të identifikimit apo verifikimit në lidhje me klientët/furnizuesit ekzistues.

2. Kujdesi i Duhur për Klientin/Furnizuesin duhet të synoj të:

- identifikoj klientin/furnizuesin dhe të verifikoj identitetin e tij në bazë të dokumenteve, të dhënave apo informatave të siguruar nga një burim i besueshëm dhe i pavarur dhe/apo
- (nëse është e nevojshme) të identifikoj pronarin përfitues të klientit/furnizuesit dhe të ndërmerren masat adekuate për të verifikuar identitetin e tij, duke përfshirë, në rast të një personi juridik, administratori apo rregullimi të ngjashëm ligjor, masat për të kuptuar strukturën e pronësisë dhe kontrollit të personit, administratorit apo rregullimit dhe
- sigurojnë informata mbi qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit.

Nga ne pritet gjithashtu të shqyrtojmë periodikisht Listat relative të Konsoliduara në lidhje me klientët/furnizuesit ekzistues, brenda një kohe të arsyeshme pas njoftimit për ndryshime në Listat e Konsoliduara, apo në rast të ndryshimit të të dhënave për klientët/furnizuesit ekzistues, p.sh. ndërrimi i drejtorit.

3. Shqyrtimi i palëve bashkëpunëtoare

Në rastin e organeve të korporatave, shqyrtimi mund të përfshijë çdo lloj pale tjetër të ndërlidhur, për shembull pronarët përfitues (p.sh. aksionarët, administratorët apo drejtorët e kompanive), të cilët identifikohen se ekziston nevoja të verifikohen sipas një qasje të bazuar në rrezik për kujdes të duhur ndaj konsumatorit / furnizuesit.

Si të procedohet në rastin e Përputhjes së Saktë:

Kur përputhja të konfirmohet si e saktë, p.sh., kur nuk ka asnjë dyshim se transaksioni ndodhet në kuadër të fushëveprimit të Sanksioneve, **duhet të ndërmerret veprim i duhur që të ngrihet menjëherë transaksioni përkatës.**

Përputhjet e sakta duhet të **raportohen** sa më parë që të jetë e mundur tek Menaxherët e departamenteve përkatëse dhe tek Departamenti Ligjor.

Kur nuk ka asnjë dyshim/ose besojmë se një entitet i Grupit TITAN ka marrë pagesa nga / apo ka furnizuar me mallra një Palë e cila është e Sanksionuar, kjo gjithmonë duhet t'i raportohet Menaxherit të departamentit përkatës i cili më pas është i obliguar t'ia raportoj incidentin Auditimit të Brendshëm të Grupit dhe Departamentit Ligjor të Grupit.

4. Trajnimi

Menaxherët e departamenteve të cilët me gjasë do të mund të përfshihen në çështje të Sanksioneve, sikurse tregtia, prokurimi apo financat, duhet të ndërmarrin masa të duhura në mënyrë që të gjithë punonjësit përkatës të ekipeve të tyre:

- të jenë në **dijeni** për ligjin që ka të bëjë me Sanksione dhe
- tu ofrohet trajnim **së paku një herë gjatë punësimit të tyre** me TITAN-in, se si të njohin dhe të merren me transaksione dhe aktivitete tjera të cilat mund të jenë të lidhura me Sanksione,.

5. Auditimi gjurmues dhe mbajtja e evidencës

Auditimi gjurmues i veprimeve duhet të mbahet për një periudhë jo më pak se pesë vite. Kjo do të thotë se do të regjistrohen të gjitha informatat relevante deri në një përputhje të mundshme, si është vendosur si dhe logjika e përdorur.

Shkeljet

Shkelja e Ligjit të Sanksioneve tregtare apo financiare mund të rezultojë në kryerje të veprës penale e dënueshme me burgim, gjobë apo me të dyja, si dhe shkelja e obligimeve statutore dhe kontraktuale të Grupit rezulton në dënime të rënda administrative dhe dënime të tjera.

Ndalohet të bëhet çdo gjë që ka për qëllim apo efekt shmangien nga Sanksionet.

Kur të ekzistoj një konflikt mes ligjeve të atyre juridiksioneve ku vepron Grupi i TITAN-it dhe kërkesave të Ligjeve për Sanksione, këto të fundit do të mbizotërojnë.

Përveç ndjekjes penale apo padisë civile për dëme, çdo shkelje e kësaj Politike mund të rezultojë në veprim disiplinor, duke përfshirë ndërprerjen e punësimit.

Shtojca A

Lista e sanksioneve

- Lista e konsoliduar e BE-së për sanksione
<https://www.sanctionsmap.eu/#/main>
<http://data.europa.eu/euodp/en/data/dataset/consolidated-list-of-persons-groups-and-entities-subject-to-eu-financial-sanctions>
- Programet e SHBA-së për Sanksione dhe Informatat për Shtete
<http://www.treasury.gov/resource-center/sanctions/Programs/Pages/Programs.aspx>
<http://sdnsearch.ofac.treas.gov/>
- OFAC
<http://www.treas.gov/offices/enforcement/ofac/>
- Lista e SHBA-së e Dizajnuar Veçanërisht për Shtetas
<http://www.treasury.gov/resource-center/sanctions/SDN-List/Pages/default.aspx>
- Komitetet për Sanksione, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
<https://www.un.org/securitycouncil/sanctions/information>
- Lista e Konsoliduar e Mbretërisë së Bashkuar për Caqet
<https://www.gov.uk/government/collections/financial-sanctions-regime-specific-consolidated-lists-and-releases>
- Thesari i Mbretërisë së Bashkuar (HM Treasury)
http://www.hm-treasury.gov.uk/fin_sanctions_index.htm

(Përmbajtja duhet të përditësohet periodikisht pasi që mund të jetë e nevojshme)

Shtojca B

“Blerësi bën deklarinimet dhe garancitë në vijim për [Shitësit/Furnizuesit] të cilat duhet të jenë të vërteta dhe të sakta gjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj [Kontrate/Marrëveshje]:

- (Blerësi), [filialet e tij dhe drejtorët apo zyrtarët e tyre përkatës]¹, dhe sipas njohurisë së (Blerësit), punonjësit dhe agjentët e tij, veprojnë në përputhje me të gjitha Sanksionet në fuqi në të gjitha çështjet materiale
- Asnjë:
Blerës, [asnjë filial] apo sipas njohurisë së (Blerësit) [apo të ndonjë filiali], asnjë drejtor, zyrtar apo punonjësit i tyre nuk është Person i Sanksionuar apo nuk vepron në asnjë cilësi në lidhje me apo në dobi të kësaj marrëveshje për një Person të Sanksionuar
- Asnjë pagesë e pranuar nga (Shitësi) apo transaksion tjetër i menduar për këtë marrëveshje nuk do të shkelë Sanksionet në fuqi.

Sanksion do të thotë sanksion ekonomik apo financiar, apo embargo tregtare të shqiptuara, administruara apo zbatuara kohë pas kohë nga qeveria e Sh.B.A-së (duke përfshirë ato të administruara nga Zyra për Kontrollin e Pasurisë së Huaj e Departament Amerikan të Thesarit apo nga Departamenti i Shtetit të Sh.B.A-së), Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian; apo Mbretëria e Bashkuar.

Personi i sanksionuar do të thotë çdo person i listuar në çdo listë të Sanksioneve për persona të caktuar, për çdo person që është duke vepruar, që është i organizuar apo që është banor në një Shtet të Sanksionuar; apo çdo person i kontrolluar nga një person i tillë.

Shteti i sanksionuar do të thotë, në çdo kohë, një vend apo territor i cili i nënshtrohet apo është cak i çfarëdo Sanksioni.

(Përmbajtja duhet të përditësohet periodikisht pasi që mund të jetë e nevojshme)

¹ Ju lutem largoni tekstin në kllapa nëse blerësi është individ e jo person juridik.

Shtojca C

VETËM PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM

TË PLOTËSOHET NGA KLIENTI APO, KUR ËSHTË E NEVOJSHME, NGA ZYRTARI I TITAN-it PËR MARRËDHËNIE

Pyetësori i ekspozimit ndaj sanksioneve

Emri i Klientit/Furnizuesit (“Kompania”):	Data:
Dëshmi për identitetin dhe dëshmi për adresën e banimit ☐ E konfirmuar	Dita-Muaji-Viti
a. A është kompania ose ndonjë filial, sipas njohurive tuaja, ose (nëse është e aplikueshme) ndonjë anije/port në pronësi ose operim nga Kompania, aktualisht në shënjestër nga sanksionet e administruara nga organet e mëposhtme: OKB, BE, UKHMT, OFAC, ose si pjesë e ligjit lokal të sanksioneve? Filialë konsiderohen subjektet që kanë kontroll efektiv mbi shoqërinë dhe subjektet mbi të cilat shoqëria ka kontroll efektiv.	☐ Po ☐ Jo
b. A ka Kompania sipas njohurive tua më të mirë ndonjë aktivitet biznesor aktual apo të planifikuar në Shtete të Sanksionuara si Irani, Sudani, Korea Veriore, Siria, Kuba, Sudani Jugor, Belarusia, Zimbabve, Myanmar (Burma)? Aktiviteti biznesor përfshinë operacionet, furnizuesit, konsumatorët, agjentët, origjinën apo transportin e mallrave dhe ndërveprimet/ekspozimi ndaj entiteteve në pronësi të shtetit apo të kontrolluara nga shteti.	☐ Po ☐ Jo
c. Sipas njohurive tuaja më të mira, a ka ndonjë palë që është e lidhur apo ndonjë palë tjetër e ndërlidhur me Kompaninë (Palët e Lidhura apo Palët Tjera të Ndërlidhura, që përfshinë, por nuk kufizohen në, pronarët, drejtorët, zyrtarët e aksionarëve, konsumatorët, furnizuesit, agjentët apo distributorët e klientit përfitues) prani në ndonjë Vend të Saksionuar, si, indikativisht, Iran, Kore të Veriut, Siri apo Kubë, dhe/apo të cilat janë aktualisht të shënjestruara nga sanksionet e administruara nga organet në vijim: BE, UKHMT, OFAC, apo sipas ligjeve të brendshme për sanksione?	☐ Po ☐ Jo
d. Sipas njohurive tua më të mira, Kompania a ka apo a planifikon ti të ketë ndonjë aktivitet biznesor të drejtpërdrejt apo të tërthortë (shembujt e “aktivitetit të tërthortë” janë shitja ndaj ndërmjetësuesit për të cilin ju e dini se pastaj ai do t’i eksporton produktet në njërin prej këtyre shteteve/rajoneve dhe aktiviteti ka një lloj përfshirje, asete apo investime me apo brenda një Shteti të Sanksionuar), apo angazhime tjera ligjore në lidhje me njërin prej këtyre shteteve/rajoneve (përmes konsumatorëve, furnizuesve, agjentëve, brokerëve, distributorëve, dhe origjinën apo transportin e mallrave)? Nëse PO, ju lutem shënoni përshkrimin e aktivitetit, duke përfshirë vendet në të cilat është i inkorporuar/regjistruar entiteti, mallrat dhe shërbimet e përfshira, konsumatorët dhe entitetet e palës së tretë të përfshira, si dhe shkallën e përfshirjes së produkteve dhe shërbimeve të TITAN-it për aktivitetin e tillë.	☐ Po ☐ Jo
Përfaqësuesi i Kompanisë/Pozicioni	Data:
(Emri/ Vula/Nënshkrimi)	

(Përmbajtja duhet të përditësohet periodikisht pasi që mund të jetë e nevojshme)